



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:066773

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06036095

CA.nr.8358/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nehat Idrizi, kryetar i kolegjit, Adnan Konushevci dhe Nora Bllaca- Dula, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit F. B., nga P..., rr. ..., të cilin e përfaqëson Haxhi Derguti, avokat nga Prishtina, rr. “Agim Ramadani”, H/32, nr.7, kundër kundërshtarit të sigurimit T. S., nga P..., lagja ..., nr...., të cilën e përfaqëson avokat Faton Qirezi, avokat nga Prishtina, rr. “Muharrem Fejza”, C15, H15, K.4, nr.23, për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të propozuesit të masës së sigurimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2691/24, të datës 03.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të propozuesit të masës së sigurimit F. B., nga P..., rr. ..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2691/24, i datës 03.06.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.2691/24, të datës 03.06.2024, në pikën një të dispozitivit të saj, e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin e propozuesit F. B., nga P..., me të cilën ka kërkuar të “caktohet masa e sigurimit, ashtu që i ndalohej të paditurës- kundërshtares së sigurimit T. S., nga P..., lagja ..., nr...., çfarëdo veprimi juridik për tjetërsimin e banesës me ngarkim apo ndonjë mënyrë tjetër, e cila gjendet në adresë Lagja ... nr.... Në pikën dy, procedura në këtë çështje juridike- kontestimore do të vazhdojë sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë propozuesi, përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, të merr vendim që ta

aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta prish dhe çështjen të ia kthej Gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi, me datë ..., përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë, ndaj kundërshtarit të sigurimit T. S. Me datë ..., kundër propozuesja ka paraqitur përgjigje në propozim, duke e kundërshtuar të njëjtin në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, administrimit dhe vlerësimit të provave materiale, ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar, me refuzimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, ndaj kunderpropozueses.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se ka bërë shikimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit dhe provave, se ka vlerësuar edhe theksimet e të autorizuarve të palëve ndërgjygjese, e që ka arritur deri tek vërtetimi i gjendjes faktike vetëm sa i përket propozimit për masë. Se propozuesi i masës së sigurimit pretendon se banesën të cekur si në padi, si në shkresa të lëndës, që gjendet në rr. ..., Mati 1, e ndërtuar në ngastrën kadastrale nr...., ZK, M..., e cila gjendet në katin e ..., me nr...., në sipërfaqe prej ... m², të cilën propozuesi në bazë të kontratës e kishte blerë në shumë totale prej euro, nga e paditura. Tutje ka theksuar se bashkëpronari i paditëses B. S., nga i cili e paditura e ka blerë banesën, e ka paditur paditësin- propozuesin që banesën ta liroj nga njerëzit dhe sendet sepse e paditura-kundërshtarja e sigurimit nuk i ka paguar çmimin e shitblerjes, e të cilën kërkesëpadi e aprovoi Gjykata Themelore dhe e vërtetoi Gjykata e Apelit.

Tutje ka arsyetuar se propozuesi i masës kërkon caktim të masës në raport me banesën e cila gjendet në adresë në Lagjen ..., nr...., ndërsa pretendon që e ka blerë banesën të cekur në padi me të dhënat si më lartë, që rrjedhimisht këto dy paluajtshmeri nuk kanë lidhshmëri mes vete. Se Gjykata ka vlerësuar edhe aktgjykimet e dorëzuara si provë, ngase palët në këtë procedurë kanë pasur pozitën e të paditurve.

Gjithashtu, ka arsyetuar se, propozuesi nuk e ka bërë të besueshëm rrezikun se banesën e cila gjendet në adresë në Lagjen ..., nr...., ndaj të cilën kërkon që të caktohet masa e sigurisë, se kundërshtarja e sigurimit mund ta tjetërsoj në ndonjë mënyrë ngase propozimin për masë Gjykata nuk e ka të qartë raportin juridik të kundërshtares së sigurimit përkitazi me pronën në fjalë dhe nëse e njëjta ka mundësi të ndërmar ndonjë veprim me të cilin do të pamundësonte propozuesin në realizimin e kërkesës sipas padisë.

Për mënyrën e vendosjes, Gjykata në shkallë të parë, ka vendosur në pajtim me nenin 297.1, pika a) dhe b), të LPK-së, nenin 304.3, e lidhur me nenin 387.1, pika l), dhe nenin 142.5, po ashtu të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë, nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore të propozuesit për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore me pretendimin se dispozitivi i aktvendimit është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e tij, ngase kjo gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktvendimit është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata në shkallë të parë, në mënyrë të drejtë duke vërtetuar gjendjen faktike, gjithashtu edhe e ka zbatuar të drejtën materiale.

Sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, neni 297, paragrafi 1 pika a) dhe b), përcaktohet në mënyrë të qartë se: masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtën subjektive të tij, në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjerave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, por që këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Me nenin 304, paragraf 3 të LPK-së, përcaktohet se: “Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit propozuesi i sigurimit duhet ta tregojë në të kërkesën, për sigurimin e të cilës bënë propozim, masën e sigurimit që e propozon, mjetet dhe objektin e masës së sigurimit. Në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim. Propozuesi i sigurimit ka për detyrë po që se ka mundësi, që mjetet provuese t’ia bashkëngjitë propozimit”.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit, vlerëson se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë për mënyrën e vendosjes është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi propozuesi kërkesën e tij për caktimin e masës së sigurisë nuk e ka bërë të besueshëm, ashtu siç edhe Gjykata në shkallë të parë ka konstatuar se nga provat në shkresë të lëndës, përveç se u vërtetua ekzistimi i një kontrate të shitblerjes, mirëpo nuk është arritur të bëhet i besueshëm pretendimi i propozuesit, se banesën e cila gjendet në adresë në Lagjen ..., nr., ndaj të cilës kërkon që të caktohet masa e sigurisë, se kundërshtarja e sigurimit mund ta tjetërsoj në ndonjë mënyrë ngase në propozimin për masë Gjykata nuk e ka të qartë raportin juridik të kundërshtares së sigurimit përkitazi me pronën në fjalë dhe nëse e njëjta ka mundësi të ndërmarr ndonjë veprim me të cilin do të pamundësonte propozuesin në realizimin e kërkesës sipas padisë, kështu që nuk mjafton vetëm të kërkohet vendosja e sigurimit të kërkesës, pa ofruar prova bindëse në lidhje me kërkesën apo të drejtën subjektive të saj, të cilin qëndrim si të bazuar në ligj, e aprovon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet e tij në ankesë, se fare nuk ka qenë në dijeni se ekziston ndonjë kontest në mes tani shitëses T. S., dhe pronarit B. S, deri sa e ka marr padinë nga Gjykata, në rastin konkret janë irelevante, pasi

Gjykata për caktimin e masës së sigurisë, vendos për gjendjen aktuale në mes palëve kontestuese, dhe jo duke pas parasysh procedure tjetër civile, e që me të drejtë edhe Gjykata në shkallë të parë, ka vlerësuar se me provat që gjenden në shkresa të lëndës nuk është arritur të argumentohet se ka ndonjë të drejtë propozuesi në raport me paluajtshmerinë kontestuese, e që tani Gjykata të veprimi sipas propozimit të propozuesit.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e tjera ankimore të autorizuarit të propozuesit, se po që se nuk aprovohet masa e sigurisë, propozuesit të sigurimit do të i rrezikohet realizimi i drejtës së tij në kompensim, pasi në rastin konkret, pala nuk ka paraqitur prova që vërtet ekziston ky rrezik dhe se mos caktimi i masës do të i paraqiste rrezik për të, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore të cekura më lartë, kështu që Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana apo shkelje të tilla që do të ndikonin për nxjerrjen e një vendimi ndryshe, për çka edhe vendosi si dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- NË PRISHTINË

CA.nr.8358/24, me datë 08.08.2024

Kryetari i kolegjit
Nehat Idrizi d.v
